

# Akt Themelimi

I shoqerise tregtare " **BEAUTY LINE BY JACQUELINE** "sh.p.k

Lushnje me date 06/02/2023

Mbeshtetur ne ligjin Nr.9901 date 14.04.2008, "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit Nr.9723,date 03.05.2007 "per Q.K.R dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare, me vullnetin e tij te lire, te shprehur dhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi ne ortaket:

## formulimi

### Neni 1

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur " **BEAUTY LINE BY JACQUELINE** "SH.P.K. .

Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacioni ku do te kete seline dega.

## Selia e Shoqerise

### Neni 2

Selia e shoqerise :

Selia e shoqerise do te jete ne Lagjja Kongresi i Lushnjes, Rruga Vojo Kushi, Zyre LR 16.04.08, Lushnje Qytet /E-A7/9P, prane Kinoteatrit LU 0755, pallati i Ri i Rezartit prane TV 7, kati i 2-te, tavolina nr. 2.

Per qellime te komunikimit elektronik do te jete adresa **nderto.as@gmail.com**



Shoqeria mund te ndryshoj seline e saj, te hape zyra perfaqesie,dege,te krijoj filiale si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese dhe ortakut te vetem.

## Objektimi I Veprimtarise

### Neni 3

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat e :

Shitje e produkteve kozmetike.

## Kohezgjatja e shoqerise

### Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat

Ajo mund te zgjase afatin ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkaku.

Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkaku.


## Kapitali I Shoqerise

### Neni 5

Kapitali fillestar i shoqerise private " **BEAUTY LINE BY JACQUELINE** "sh.p.k do te jete **12.000 (DYMBEDHJETEMIJE (LEKE))**

Kapitali eshte 100% nga kuotat e ortakeve, e ndare ne 1 kuote.

Kapitali themeluar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet (por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar).



## Drejtimi I Shoqerise

### Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj, ortaket e saj.

Ai ( Administratori) eshte perfaqshues i shoqerise ne mardhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj.

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqshues i pajisur me prokure te posacme.

### Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve te shoqerise.

### Neni 8

Ortaket themelues kane te drejte te emerojne dhe administratore te tjere te vlerave materiale. Kane te drejte te caktoje financiere, likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona tjere si ortake.

### Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatën shqiptare , rrethi ne varesi te vendit me te afert te selise ne momentin e lindjes se konfliktit .

### Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin rreth saj.

### Neni 11



Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.20018 " per krijimin e shoqerive tregtare" , si dhe duke zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri.

**Neni 12**

Akti i themelimit u perpilua ne 2 kopje, per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baza te shoqerise"

Akti i themelimit nenshkruset rregullisht

" BEAUTY LINE BY JACQUELINE "sh.p.k

Ortaket

A handwritten signature in blue ink, reading "Gastriot Bek". The signature is written in a cursive style with a long horizontal flourish extending to the right.